Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Datë/Datum 26.06.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA
314/20

PSH .nr.314/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina – Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Euro Kosova" SH.P.K.-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik OE: N.T.SH "Nord" -Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material higjenik" me nr. prokurimit: 701-20-1272-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- QKUK, më datë: 25.06.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Euro Kosova" SH.P.K.-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material higjenik" me nr. prokurimit: 701-20-1272-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- QKUK.

II.VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: "Furnizim me material higjenik" me nr. prokurimit: 701-20-1272-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- QKUK.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Euro Kosova" SH.P.K.-Prishtinë,, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues "Euro Kosova" SH.P.K.-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 18.05.2020 me nr 314/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material higjenik" me nr. prokurimit: 701-20-1272-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- QKUK, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7, 59 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 21.05.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 01.06.2020 sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin 1
Lidhur me pretendimin e OE ankues"EuroKosova" se AK gjate fazës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka rekomanduar për kontratë ofertën e OE N.T.SH "Nord" edhe pse kjo ofertë nuk është konform kërkesave të dosjes së tenderit, konkretisht nuk përmbush kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, ku sipas OE ankues OE të rekomanduar për kontratë i mungon certifikata e re me numër Unik Identifikues si dhe i mungojnë aktivitetet adekuate që merren me këtë veprimtari.
Ekspertit shqyrtues konstaton se në dosjen e tenderit tek kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, konkretisht kërksa1.nga OE është kërkuar "Certifikatë e regjistrimit të biznesit ,regjistrimi si operator

ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit e dëshmuar me Certifikatë te Regjistrimit te Biznesit si dhe me informacione te biznesit-Kopje. OE i rekomanduar për kontrate N.T.SH "Nord" në ofertën e tij ka dorëzuar edhe certifikatën e regjistrimit të biznesit me numër të biznesit"70777592" se bashku me informacionet e biznesit.
Sa i përket pretendimit të OE ankues se kjo certifikatë nuk është e re dhe i mungon numri Unik Identifikues, ekspertit shqyrtues sqaron se ka verifikuar në faqen zyrtare të Agjencisë së regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) dhe OE N.T.SH"Nord" rezulton i regjistruar me numër Unik Identifikues 810912718, emër të biznesit "NitaMacaula"B.I. dhe emër tregtar N.T.SH'Nord".

Sa i përket aktiviteteve në informacionet e biznesit se nuk janë adekuate, eksperti shqyrtues sqaron se në kërkesën e dosjes së tenderit nuk është kërkuar që OE duhet të jenë të regjistruar me ndonjë aktivitet specifik por vetëm është kërkuar certifikata e biznesit.
Konsideroj qe certifikata e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratës të konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 2.
Sa i përket pretendimit tjetër se OE i rekomanduar për kontratë nuk përmbush kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, konkretisht kërkesën 1,ku sipas OE ankues, OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar një reference për realizimin e furnizimeve të ngjashme por ka dorëzuar një faturë dhe fletë dërgese për furnzimin e bërë për klientin/OE "Rilindja" Skenderaj dhe sipas OE ankues kjo dëshmi nuk është konform kërkesës së dosjes së tenderit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.
Ne dosjen e tenderit tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, konkretisht kërkesa 1 nga OE është kërkuar të prezantoj ne ofertën e tij se paku 1 (një) reference për realizimin e furnizimeve te ngjashme përgjatë 3 viteve te shkuara nga data e njoftimit për kontratë.

OE i rekomanduar për kontrate N.T.SH "Nord" në ofertën si dëshmi për realizimin e furnizimeve të ngjashme ka dorëzuar një fature dhe fletë dërgese me nr.74-210-001-20 të datës 03.04.2020 në vlerë prej 450.00 € si furnizim(shitje) i realizuar ndaj blerësit N.T.L'Rilindja" Skenderaj.

Gjatë afatit të kërkesës për rishqyrtim të paraqitur nga OE ankues "Euro Kosova", AK konfom nenit 72 të LPP-së ka kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë që të dërgoj referencën dhe katalogun e produkteve sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe pas kësaj kërkese OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar katalogun dhe një reference nga OE N.T.L "Rilindja" Skenderaj të datës 03.04.2020.

Me datë 28.05.2020 përmes e-mailit nga OE i rekomanduar për kontratë kam kërkuar dëshminë e pagesës për këtë translacion nëse pagesa është bërë përmes transferit bankar.
Në të njejtën datë nga OE i rekomanduar për kontratë kam pranuar një përgjigje që kjo pagesë është bërë më para të gatshme(cash) dhe nuk është realizuar përmes transferit bankar (sipas rregullave të ATK-së pagesat deri ne 500.00 € mund të bëhen me para të gatshme (cash).
Gjithashtu nga OE i rekomanduar për kontratë kam pranuar edhe kartelën financiare për transaksionin e realizuar,librin e arkës dhe librin e shitjes në të cilat rezulton i realizuar ky transaksion sipas datës dhe shumës së njëjtë dhe në emër të njëjtë të blerësit.(N.T.L "Rilindja").

Me datë 01.06.2020 nga ATK kam kërkuar dëshmi për librin e shitjes për OE N.T.L "Rilindja" (blersi i mallit nga OE "Nord"Shpk) për të verifikuar nëse transkacioni është regjistruar në librin e blerjes,por ndoshta edhe për shkak të kohës së shkurtër apo edhe situatës në administratën e institucionit(pandemia covid -19) nuk kam pranuar përgjigje nga ATK.

Gjithsesi në bazë të dokumenteve të dërguara dhe sqarimeve të më sipërme për ekspertin shqyrtues,OE i rekomanduar për kontratë përmbush këtë kërkese të dosjes së tenderit. Pretendimi ankimor është i pabazuar.
Mendimi i ekspertit profesional: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të **refuzohet si e pabazuar** dhe rekomandon autoritetin kontraktues që të **vazhdoj** me lidhjen e kontratës

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës 04.06.2020 ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me raportin e ekspertit profesional.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës 01.06.2020 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me raportin e ekspertit profesional.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 25.06.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues/teknik deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa e OE ankues është kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin e OE ankues " EuroKosova" se AK gjate fazës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka rekomanduar për kontratë ofertën e OE N.T.SH "Nord" edhe pse kjo ofertë nuk është konform kërkesave të dosjes së tenderit, konkretisht nuk përmbush kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, ku sipas OE ankues operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë i mungon certifikata e re me numër Unik Identifikues si dhe i mungojnë aktivitetet adekuate që merren me këtë veprimtari.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se në dosjen e tenderit tek kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, konkretisht kërksa1.nga OE është kërkuar "Certifikatë e regjistrimit të biznesit ,regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit e dëshmuar me Certifikatë te Regjistrimit te Biznesit si dhe me informacione te biznesit-Kopje. OE i rekomanduar për kontrate N.T.SH "Nord" në ofertën e tij ka dorëzuar edhe certifikatën e regjistrimit të biznesit me numër të biznesit"70777592" se bashku me informacionet e biznesit.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se kjo certifikatë nuk është e re dhe i mungon numri Unik Identifikues. Paneli shqyrtues sqaron se eksperti shqyrtues gjatë analizimit të lëndës ka verifikuar në faqen zyrtare të Agjencisë së regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) dhe ka vërtetuar se OE N.T.SH"Nord" rezulton i regjistruar me numër Unik Identifikues 810912718, emër të biznesit "NitaMacaula"B.I. dhe emër tregtar N.T.SH'Nord", andaj ka te cekurat si me lart konstatohet se OE i rekomanduar OE N.T.SH"Nord" rezulton i regjistruar me numër Unik Identifikues 810912718, emër të biznesit "NitaMacaula"B.I.

Paneli shqyrtues konform eksperti shqyrtues konstaton se në kërkesën e dosjes së tenderit nuk është kërkuar që OE duhet të jenë të regjistruar me ndonjë aktivitet specifik por vetëm është kërkuar certifikata e biznesit. Andaj certifikata e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratës të konform kërkesës së dosjes së tenderit.

Sa i përket pretendimit tjetër se OE i rekomanduar për kontratë nuk përmbush kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, konkretisht kërkesën 1, ku sipas OE ankues, OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar një referencë për realizimin e furnizimeve të ngjashme por ka dorëzuar një faturë dhe fletë dërgese për furnzimin e bërë për klientin/OE "Rilindja" Skenderaj dhe sipas OE ankues kjo dëshmi nuk është konform kërkesës së dosjes së tenderit. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se në dosjen e tenderit tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, konkretisht kërkesa 1 nga OE është kërkuar të prezantoj ne ofertën e tij se paku 1 (një) reference për realizimin e furnizimeve te ngjashme përgjatë 3 viteve te shkuara nga data e njoftimit për kontratë. OE i rekomanduar për kontrate N.T.SH "Nord" në ofertën si dëshmi për realizimin e furnizimeve të ngjashme ka dorëzuar një fature dhe fletë dërgese me nr.74-210-001-20 të datës 03.04.2020 në vlerë prej 450.00 € si furnizim(shitje) i realizuar ndaj blerësit N.T.L'Rilindja" Skenderaj.
Gjatë afatit të kërkesës për rishqyrtim të paraqitur nga OE ankues "Euro Kosova", AK konfom nenit 72 të LPP-së ka kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë që të dërgoj referencën dhe katalogun e produkteve sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe pas kësaj kërkese OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar katalogun dhe një reference nga OE N.T.L "Rilindja" Skenderaj të datës 03.04.2020.

Paneli shqyrtues sqaron se eksperti shqyrtues me datë 28.05.2020 përmes e-mailit nga OE i rekomanduar për kontratë ka kërkuar dëshminë e pagesës për këtë transakcion nëse pagesa është bërë përmes transferit bankar.
Në të njëjtën datë nga OE i rekomanduar për kontratë eksperti ka pranuar një përgjigje që kjo pagesë është bërë më para të gatshme(cash) dhe nuk është realizuar përmes transferit bankar (sipas rregullave të ATK-së pagesat deri ne 500.00 € mund të bëhen me para të gatshme (cash).
Gjithashtu nga OE i rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues ka pranuar edhe kartelën financiare për transaksionin e realizuar, librin e arkës dhe librin e shitjes në të cilat rezulton i realizuar ky transaksion sipas datës dhe shumës së njëjtë dhe në emër të njëjtë të blerësit.(N.T.L "Rilindja").

Me datë 01.06.2020 nga ATK , Eksperti shqyrtues ka kërkuar dëshmi për librin e shitjes për OE N.T.L "Rilindja" (blerësi i mallit nga OE "Nord"Shpk) për të verifikuar nëse transaksioni është regjistruar në librin e blerjes, por ndoshta edhe për shkak të kohës së shkurtër apo edhe situatës në administratën e institucionit(pandemia covid -19) nuk eksperti nuk ka pranuar përgjigje nga ATK.

Andaj duke u bazuar në dokumentet e dërguara dhe sqarimeve të më sipërme për ekspertin shqyrtues, Paneli shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar për kontratë përmbush këtë kërkese të dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve për aktivitetin e prokurimit ne fjalë është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, konform nenit 60 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- QKUK

1x1 OE- "Euro Kosova" SH.P.K.-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.